Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.8926, datë 22.7.2002 “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditën e shtunë, më 8 gusht 2009, ditë zie kombëtare, në nderim të punonjësve të Policisë së Shtetit, të rënë në krye të detyrës në ngjarjen e datës 7 gusht 2009, gjatë përmbushjes së misionit të tyre, për ndalimin e një shtetasi shumë të kërkuar nga organet e drejtësisë për veprimtarinë e tij kriminale.

2. Në të gjitha institucionet, shtetërore dhe publike, flamuri kombëtar të ulet në gjysmë shtizë. Në orën 12:00, në nderim të tyre, të ndërpritet çdo veprimtari dhe të mbahet një minutë heshtje.

3. Ngarkohet Ministria e Brendshme të organizojë ceremonialin dhe të përballojë shpenzimet për varrimin e të rënëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 842, datë 7.8.2009

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE 4 FAMILJEVE, TË ISH- PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, VRARË NË KRYE TË DETYRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, prej 5 000 000 (pesë milionë) lekësh, për secilën familje, të të ndjerëve Fatos Haqir Xhani, Kastriot Çlirim Feskja, Saimir Islam Duçkollari dhe Altin Idriz Dizdari, ish – punonjës policie në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, vrarë në krye të detyrës.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.843, datë 8.8.2009

PËR LIRIMIN DHE EMËRIMIN NË DETYRË TË PREFEKTIT TË QARKUT TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 e 114 të Kushtetutës dhe të nenit 4 të ligjit nr.8927, datë 25.7.2002 “Për prefektin”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Z.Ruzhdi Keçi, prefekt i qarkut të Tiranës, lirohet nga kjo detyrë.
 2. Z.Keltis Kruja emërohet prefekt i qarkut të Tiranës.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.850, datë 5.8.2009

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM QENDRËS KOMBËTARE TË APLIKIMEVE PËR ENERGIJINË TË DISA MJEDISEVE NË NDËRTESËN (GODINËN) E ISH-INIMA-S

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 10 e 13 të ligjit nr.8743, datë 23.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave


VENDOSI:

1. Dhënie në përdorim Qendrës Kombëtare të Aplikimeve për Energjinë të disa mjediseve në katin e parë të ndërtesës së ish-INIMA-s, në administrim të Këshillit të Ministrave, sipas vendndodhjes, të përcaktuar në planimetrinë, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Kryeministria dhe Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Sipërfaqja e kerkuar
per **QKE**



VENDIM
Nr.866, datë 12.8.2009

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES DHE TË PROTOKOLLIT ZBATUES TË SAJ,
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË ITALISË, NË FUSHËN E PUNËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes dhe të protokollit zbatues të saj, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Italisë, në fushën e punës, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

**DYPALËSHE NË FUSHËN E PUNËS NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE**

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës Italiane, të emërtuara këtu në vijim “Palët kontraktuese”;

me objektivin për të forcuar marrëdhëniet e miqësisë dhe të bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve;

duke pasur parasysh parimet e sanksionuara nga instrumentet ndërkombëtarë në lidhje me të drejtat e punonjësve migrantë dhe me të drejtat themelore të punonjësve;

me qëllim që të administrohen në mënyrë të bashkërenduar dhe të efektshme flukset e punonjësve migrantë në drejtim të të dy shteteve;

me objektivin e përforcimit të marrëdhënieve të bashkëpunimit që ekzistojnë ndërmjet palëve kontraktuese në kuadrin e interesave të përbashkëta për të dy vendet, ranë dakord për sa më poshtë vijon:

Neni 1

Autoritetet kompetente për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje janë:

- Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë: Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta
- Për Qeverinë e Republikës Italiane: Ministria e Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale.

Neni 2

Autoritetet kompetente do të bashkëpunojnë për rregullimin dhe për organizimin e flukseve të punonjësve ndërmjet dy vendeve dhe do të lehtësojnë rekrutimin dhe futjen e shtetasve të palës tjetër në tregun e brendshëm të punës, në rast mungese të krahut të punës vendas.

Neni 3

Mbi bazën e kushteve të tregut të punës dhe sipas legjislacionit kombëtar në fuqi, pala italiane do të shqyrtojë pozitivisht dhënien e një kuote të rezervuar hyrjesh për shtetasit shqiptarë.

Neni 4

Shtetasit shqiptarë që kërkojnë të ushtrorjnë një aktivitet pune pranë një punëdhënësi, edhe sezonale, në Itali, mund të përfshihen në një listë të hartuar nga pala shqiptare, sipas kriterëve të treguara nga pala italiane mbi bazën e legjislacionit të vet.

Lista do t'i përcillet në mënyrë telematike nga pala shqiptare palës italiane, e cila do ta përhapë sipas mënyrave të parashikuara nga dispozitat ligjore italiane.

Neni 5

Një përqindje e kuotës së privilegjuar që i është caktuar Shqipërisë, e barabartë me një të katrën e totalit, mund të përdoret me përparësi përmes sistemit të listave të përmendura në nenin 4.

Neni 6

Palët kontraktuese do të shkëmbejnë rregullisht informacione në lidhje me dy tregjet e punës. Palët kontraktuese marrin përsipër që të lehtësojnë takimin ndërmjet kërkesës dhe ofertës së punës, edhe nëpërmjet mbështetjes dhe asistencës ndaj organizmave kompetentë në këtë sektor në të dyja vendet, dhe të kryejnë monitorimin e ofertave të punës të disponueshme në njërin apo në tjetrin vend.

Neni 7

Palët kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e tyre kombëtar, do të nxisin formimin e punonjësve që do të jenë kandidatë për të migruar në vendin tjetër, me qëllim që të japin personel të kualifikuar që t'i përgjigjet profileve profesionale të kërkuara nga tregu i punës i vendi pritës.

Neni 8

Palët kontraktuese do të nxisin pjesëmarrjen e kandidatëve të mundshëm për emigracion në kurse formimi profesional dhe të gjuhës italiane të organizuara në Shqipëri.

Neni 9

Hyrja, qëndrimi dhe aktiviteti i punonjësit që do të emigrojë, do të kryhen në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 10

Punonjësit e palëve kontraktuese, rezidentë në territorin e vendit tjetër për arsye pune, munden t'i transferojnë fitimet e tyre në vendin e origjinës, në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 11

Shtetasit e të dyja palëve kontraktuese, që ushtrorjnë një aktivitet pune në territorin e palës tjetër, gëzojnë të njëjtat të drejta dhe të njëjtat mbrojtje që gëzojnë edhe punonjësit e vendit pritës, përsa u përket qoftë kushteve të punës, mbrojtjes shoqërore, përfitimeve shoqërore, qoftë të drejtave themelore të punonjësve, në përputhje me ligjet në fuqi në vendin pritës.

Neni 12

Përfaqësuesit e palëve kontraktuese do të këshillohen rregullisht, me qëllim që:

- Të ndjekin zbatimin e marrëveshjes dhe të propozojnë çfarëdolloj mase, e cila mund të sigurojë funksionimin e mirë të saj;

- të kryejnë një vlerësim periodik të marrëveshjes;
- Të zgjidhin vështirësitë me karakter praktik, të cilat mund të pengojnë zbatimin e marrëveshjes;
- Të propozojnë ndryshime në marrëveshje.

Neni 13

Mënyrat e zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të përcaktohen nga protokollet zbatuese që do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme të parashikuara nga secila prej dy palëve kontraktuese.

Neni 14

Palët kontraktuese, me marrëveshje të përbashkët, mund të nënshkruajnë protokolle shtesë që do të hyjnë në fuqi sipas procedurave të brendshme të parashikuara nga secila prej dy palëve kontraktuese.

Neni 15

Kjo marrëveshje ka një kohëzgjatje të pacaktuar, me përjashtim të denoncimit, për të cilin njëra prej palëve kontraktuese njofton palën tjetër në rrugë diplomatike.

Denoncimi do të hyjë në fuqi pasi të kenë kaluar 60 (gjashtëdhjetë) ditë nga njoftimi i tij.

Neni 16

Të dyja palët kontraktuese marrin përsipër, secila në territorin e vet kombëtar, që të nxisin njohjen e gjerë të dispozitave të kësaj marrëveshjeje.

Neni 17

Kjo marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të dytë pas marrjes së njoftimit të fundit, me anën e të cilit të dyja palët do t'i bëjnë të ditur njëra-tjetrës përmbushjen e procedurave të brendshme, të nevojshme për hyrjen e saj në fuqi.

Me bindje për sa më sipër, të nënshkruarit, përfaqësues të autorizuar nga qeveritë përkatëse, nënshkruan këtë marrëveshje.

Hartuar në Tiranë, më 2 dhjetor 2008, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze të gjitha tekstet njësoj të barasvlefshme. Në rast mosmarrëveshje, do të merret për bazë teksti në anglisht.

PROTOKOLLI ZBATUES I MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS ITALIANE NË FUSHËN E PUNËS

Neni 1

Ky protokoll rregullon hyrjen në Itali për arsye pune pranë një punëdhënësi, sezonale dhe jo sezonale, të shtetasve shqiptarë, në përputhje me ligjet italiane në fuqi mbi hyrjen në territorin e Republikës Italiane për arsye pune të shtetasve që nuk i përkasin Bashkimit Europian.

Neni 2

Ky protokoll zbatohet për shtetasit shqiptarë, kandidatë për të kryer një punë pranë një punëdhënësi, sezonale ose jo sezonale, në territorin italian.

Neni 3

Me qëllim që të lehtësohet rregullimi dhe organizimi i flukseve të punonjësve shqiptarë në drejtim të Italisë, pala italiane do t'i japë palës shqiptare informacione të hollësishme mbi ofertat e punës që vijnë nga punëdhënësit italianë.

Ajo do të japë, gjithashtu, edhe informacione që kanë të bëjnë me legjislacionin italian në çështjet e kushteve të punës, banesës dhe sigurisë shoqërore në Itali.

Informacione të hollësishme do të përmbajë edhe kontrata e punës që punëdhënësi do t'i paraqesë punonjësit.

Autoritetet shqiptare do t'u bëjnë të ditur autoriteteve italiane se në çfarë mase mund të përmbushin këto nevoja.

Neni 4

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, me anën e Drejtorisë së Politikave të Migracionit, do të veprojë mbi bazën e prirjeve të tregut të punës dhe të ofertave të punës të sistemit kombëtar për hartimin e një liste kandidatësh shqiptarë përkatës.

Lista e kandidatëve e përpunuar për këtë qëllim, do të ketë parasysh kriteret e përcaktuara nga Ministria Italiane e Punës, e Shëndetit dhe e Politikave Sociale dhe do të përfshijë, ndër të tjera, informacione në lidhje me arsimimin e punonjësve, me kualifikimin e tyre dhe përvojën profesionale, si edhe nivelin e tyre të njohjes së gjuhës italiane.

Kjo listë i përcillet në mënyrë telematike Ministrisë Italiane të Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale, nëpërmjet përfaqësive diplomatike dhe konsullore, nga organizmat shqiptarë kompetentë, në mënyrë që ajo t'u shpërndahet punëdhënësve italianë.

Punëdhënësit italianë që interesohen për kandidatët e treguar në listë, mund të kontaktojnë Shërbimin Kombëtar të Punësimit, që merr përsipër të lehtësojë takimin e tyre me kandidatët e përzgjedhur.

Neni 5

Përzgjedhja përfundimtare e kandidatëve do të jetë në ngarkim të punëdhënësve ose të përfaqësuesve të tyre në qoftë se do të jetë e nevojshme me bashkëpunimin e Shërbimit Kombëtar të Punësimit.

Neni 6

Punësimi i punonjësve shqiptarë do të kryhet me kontratë pune individuale, të hartuar sipas kushteve të parashikuara nga ligjet italiane në fuqi.

Kandidatët e përzgjedhur duhet të gëzojnë kushtet shëndetësore që i bëjnë ata të aftë për kryerjen e funksioneve për të cilat janë caktuar që të punojnë në Itali dhe do të mund t'i nënshtrohen një kontrolli mjekësor në ngarkim të punëdhënësit.

Neni 7

Palët kontraktuese do të mbështesin aktivimin e kurseve të formimit profesional dhe të mësimin të gjuhës italiane për shtetasit shqiptarë kandidatë për të punuar në Itali, të organizuar në territorin shqiptar, sipas kushteve të përcaktuara me marrëveshje të përbashkët.

Kurset e formimit profesional dhe të mësimin të gjuhës italiane, të parashikuara nga neni 23 i ligjit italian mbi emigracionin, do të organizohen sipas dispozitave në vijim:

- Programet e formimit të miratuara nga Ministria Italiane e Punës, Shëndetit dhe e Politikave Sociale i komunikohen Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

- Programet e formimit do të organizohen dhe do të realizohen sipas ligjeve shqiptare në fuqi.

- Kandidatët shqiptarë që do të kenë marrë pjesë në kurse formimi, pavarësisht edhe nga ofertat e punës, do të përfshihen në një listë me përparësi, me qëllim që të fitojnë një të drejtë përparësie për hyrjen në Itali për arsye pune.

- Të gjitha shpenzimet e formimit do të jenë vetëm në ngarkim të punëdhënësve ose të subjekteve organizuese të formimit.

Neni 8

Kandidatët për një ofertë pune do të informohen se me të mbaruar afati i lejes së tyre të qëndrimit për arsye pune, sezonale ose josezonale, duhet të largohen nga territori italian, në përputhje me ligjet kombëtare italiane në fuqi dhe t'u vendoset në pasaportën e tyre vula e daljes, pasi t'u kenë dorëzuar lejen e qëndrimit organeve të policisë kufitare italiane.

Neni 9

Konsultimet e parashikuara nga neni 12 i marrëveshjes do të zhvillohen në kuadrin e takimeve ndërmjet përfaqësuesve të autoriteteve kompetente të të dyja palëve.

Neni 10

Ky protokoll përmban dispozitat për zbatimin e marrëveshjes dhe do të hyjë në fuqi në të njëjtën ditë me marrëveshjen. Palët kontraktuese mund të bëjnë ndryshime në këtë protokoll, me marrëveshje të përbashkët, në rrugë diplomatike.

Neni 11

Për aspektet që nuk janë rregulluar nga marrëveshja ose nga ky protokoll, palët do t'i referohen legjislacionit italian në lidhje me çështjet e hyrjes, të punësimit dhe të qëndrimit të punonjësve të vendeve që nuk i përkasin Bashkimit Europian, si edhe mënyrave të zbatimit të ndërmarra nga autoritetet kompetente italiane.

Hartuar në Tiranë, më 2 dhjetor 2008, në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe, italiane dhe angleze, të gjitha tekstet njësoj të barasvlefshme. Në rast mosmarrëveshje, do të merret për bazë teksti në anglisht.

VENDIM

Nr. 892, datë 19.8.2009

PËR SHPËRBLIMIN E DISA PUNONJËSVE TË POLICISË SË FORCËS SË POSAÇME, NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË POLICISË SË SHETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimin në masën 1 000 000 (një milion) lekë, të çdo punonjësi të policisë së forcës të posaçme, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët morën pjesë në operacionin për kapjen e disa personave me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

2. Lista me emrat e punonjësve të përcaktohet nga Ministri i Brendshëm.

3. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, t'i shtohet një fond prej 12 000 000 (dymbëdhjetë milionë) lekësh, për shpërblimin e punonjësve, që do të përcaktohen sipas pikës 2 të këtij vendimi.

4. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.905, datë 26.8.2009

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË DYTË, TË TRETË DHE TË KATËRT PERIODIK,
KOMBËTAR, NË ZBATIM TË KONVENTËS “PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE”**

Në mbështetje të neneve 100 e 122 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.7531, datë 11.12.1991 “Për ratifikimin e konventës “Për të drejtat e fëmijëve””, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e raportit të dytë, të tretë dhe të katërt periodik, kombëtar, në zbatim të konventës “Për të drejtat e fëmijëve”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.906, datë 26.8.2009

**PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE FAMILJEVE, SHTËPITË DHE PRONAT E TË
CILAVE, TË NDODHURA BRENDA PERIMETRIT, ME RREZE 300 M NGA VATRA E
SHPËRTHIMIT, JANË SHKATËRRUAR PLOTËSISHT NGA AKSIDENTI
TEKNOLOGJIK, I DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e një ndihme financiare:

a) prej 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekësh në muaj, për pagesën e qirasë së banesës, për një periudhë tjetër 1-vjeçare, familjeve, shtëpitë e të cilave ndodheshin brenda perimetrit, me rreze 300 m nga vatra e shpërthimit, gjatë aksidentit teknologjik, të datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

b) familjeve, që disponojnë tokë brenda perimetrit, me rreze 300 m nga vatra e shpërthimit, gjatë aksidentit teknologjik, të datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, por që nuk po e shfrytëzojnë atë, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

c) familjeve, që disponojnë sipërfaqe me ullishte, brenda perimetrit, me rreze 300 m nga vatra e shpërthimit gjatë aksidentit teknologjik, të datës 15 mars 2008, në fshatin Gërdec, bashkia Vorë, por që nuk i shfrytëzojnë ato, sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2009, t'i shtohet fondi 6 509 400 (gjashtë milionë e pesëqind e nëntë mijë e katërqind) lekë, për përballimin e efekteve financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohet bashkia Vorë të kryejë pagesat për familjarët, sipas lidhjeve nr.1, nr.2 dhe nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Financave dhe bashkia Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet financiare nga data 21.5.2009.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.1

**LISTA E FAMILJEVE, SHTËPITË E TË CILËVE NDODHESHIN BRENDIA
PERIMETRIT, ME RREZE 300 M TË KRATERIT TË AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË
DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Shuma lekë Në muaj
1	Bajram	Ramazan	Leti	25000
2	Kujtim	Nezir	Halili	25000
3	Fatos	Myslim	Aliu	25000
4	Myslim	Zenjel	Aliu	25000
5	Muhamet	Osman	Skeja	25000
6	Astrit	Osman	Skeja	25000
7	Gëzim	Osman	Skeja	25000
8	Xhamije	Osman	Skeja	25000
9	Rruzhdi	Hamit	Sina	25000
10	Hamit	Zyber	Sina	25000
11	Xhabir	Hamit	Sina	25000
12	Gëzim	Ali	Alla	25000
13	Uran	Qemal	Deliu	25000
14	Ilirjan	Qemal	Deliu	25000
15	Gentjan	Qemal	Aliu	25000

Totali për 12 muaj: 4 500 000 (katër milionë e pesëqind mijë) lekë.

Kjo tabelë mbyllet me numër rendor 15.

LISTA E FAMILJEVE, QË KANË SIPËRFAQE TË TOKAVE BUJQËSORE, BRENDA PERIMETRIT, ME RREZE 300 M TË KRATERIT TË AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË, POR QË NUK I SHRYTËZOJNË ATO

Nr.	Emër.Atësi,Mbiemër	Kultura	Sip.m ²	Rendimenti Kv/ha	Prodhimi njomishte kv	Çmimi lekë/kv	Vlera në lekë
1	Shefqet Imer Aliu	Bar	900	100	9	100	900
2	Hajdar Imer Aliu	Bar	1500	100	15	100	1500
3	Gani Sefer Aliu	Bar	2500	100	25	100	2500
4	Agim Ali Alla	Jonxhë	10800	400	432	500	216000
5	Ramazan Rushit Picari	Jonxhë	12000	100	480	500	240000
6	Haki Zenel Aliu	Bar	2000	100	20	100	2000
7	Myslim Zenel Aliu	Jonxhë	3000	400	120	500	60000
8	Bajram Ramazan Leti	Jonxhë	2316	400	92.6	500	46300
9	Halil Sulejman Halili	Jonxhë	1000	400	40	500	20000
10	Haki Zenel Aliu	Jonxhë	3000	400	120	500	60000
11	Islam Ahmet Aliu	Jonxhë	3000	400	120	500	60000
12	Qerim Ahmet Aliu	Jonxhë	3000	400	120	500	60000
13	Kujtim Mersin Muka	Jonxhë	4000	400	160	500	80000
14	Bektash Selim Aliu	Jonxhë	5250	400	210	500	105000
15	Ramazan Ahmet Aliu	Jonxhë	3000	400	120	500	60000
	TOTALI		57266				1014200

Lista mbyllet me numër rendor 15.

LISTA E FAMILJEVE, QË KANË SIPËRFAQE ULLIShte, TË CILAT NODHESHIN BRENDA PERIMETRIT, ME RREZE 300 M TË KRATERIT TË AKSIDENTIT TEKNOLOGJIK, TË DATËS 15 MARS 2008, NË FSHATIN GËRDEC, BASHKIA VORË, DHE QË NUK E SHRYTËZOJNË ATË

Nr.	Emër Mbiemër	Kultura	Sipërfaqja m ²	Numri i rrënjëve	Rendimenti kg/rrënjë	Prodhimi në kg	Çmimi lekë/kg	Vlera në lekë
1	Ibrahim Caka	Ullinj në prodhim	2340	46	20	920	80	73600
2	Xheldin Koldashi	=	2840	56	20	1120	80	89600
3	Petrit Alla	=	910	18	20	360	80	28800
4	Zoje Gjikota	=	1000	20	20	400	80	32000
5	Besim H. Aliu	=	1000	20	20	400	80	32000
6	Deje Elqeni	=	1500	30	20	600	80	48000
7	Shaqir D. Gërdeci	=	1000	20	20	400	80	32000
8	Rruzdi H. Sina	=	3600	72	20	1440	80	115200
9	Osman Skeja	=	5000	100	20	2000	80	160000
10	Kujtim Halili	=	2200	44	20	880	80	70400
11	Myslym Z. Aliu	=	4000	80	20	1600	80	128000
12	Haki Z. Aliu	=	4000	80	20	1600	80	128000
13	Asim Gërdeci	=	1800	36	20	720	80	57600
	TOTALI		31190	622	20	12440	80	995200

Lista mbyllet me numër rendor 13.

VENDIM
Nr.914, datë 26.8.2009

**PËR PAGESËN E SHPENZIMEVE ADMINISTRATIVE TË ARBITRAZHIT
NDËRKOMBËTAR PËR ÇËSHTJEN “S.SARANDA” SHPK, V.S REPUBLIKA E
SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.12.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pagesën, me transfertë bankare, në shumën 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) USD, të shpenzimeve administrative të arbitrazhit ndërkombëtar, për çështjen “S.Saranda” sh.p.k., v.s Republika e Shqipërisë, që zhvillohet në Gjykatën Ndërkombëtare të Arbitrazhit, pranë Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, në Paris, Francë.

2. Fondi 85 000 (tetëdhjetë e pesë mijë) USD, i konvertuar në lekë, me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, në datën kur do të kryhet pagesa, i jepet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, për të bërë pagesën.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.925, datë 2.9.2009

**PËR LEJIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE PËR INVESTIMET, TË VITIT 2009, NGA
MINISTRIA E DREJTËSISË, PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË SHËRBIMIT TË
PROVËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, dhe të pikës 3 të vendimit nr.787, datë 22.7.2009 të Këshillit të Ministrave “Për një përdorim me efektivitet të fondeve për investime”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lejimin e përdorimit të fondeve për investimet të vitit 2009, me vlerë 4 800 000 (katër milionë e tetëqind mijë) lekë, nga Ministria e Drejtësisë, për Drejtorinë e Përgjithshme të Provës, për projektin “Rikonstruksion i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës”, dhe vazhdimin e mëtejshëm të procedurave të prokurimit.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Agjencia e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.938, datë 3.9.2009

PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE NJË KATEGORIE PERSONASH, TË STREHUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të nenit 12 të ligjit nr.10025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009” dhe të ligjit nr.9959, datë 17.7.2008 “Për të huajt”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënie e një ndihme financiare, prej 78 000 (shtatëdhjetë e tetë mijë) lekësh në muaj, për pagesën e qirasë së banesës, të ushqimit, energjisë elektrike e të ujit, çdo shtetasi të huaj, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Pagesa të kryhet nga strukturat e Ministrisë së Brendshme, sipas udhëzimit të Ministrit të Brendshëm.

3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit, në shumën e përcaktuar, sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr.2

EFEKTET FINANCIARE

Nr.	Emër/Mbiemër	Qera	Ndihmë financiare	Muaj	Total ndihmë financiare
1	Abu Baker Qasim	35 000	43 000	12	936 000
2	Akhadar Qasem Basit	35 000	43 000	12	936 000
3	Ahmed Adil	35 000	43 000	12	936 000
4	Ayoob Mohamed	35 000	43 000	12	936 000
5	Zakirjan Hasam	35 000	43 000	12	936 000
6	Ala Abd A-Maqsut Muhammad Mazruh	35 000	43 000	12	936 000
	TOTALI/LEK¹				5 616 000

¹ Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur është parashikuar mbulimi i shpenzimeve të qirave të banesave për një periudhë 12-mujore. Kjo pasi këta shtetas kanë firmosur kontrata qiraja banese njëvjeçare me agjencinë imobilare dhe gjykojmë që këto kontrata të përsëriten për një periudhë njëvjeçare.

Për të gjithë shtetasit e sipërpërmendur, ndihma financiare është përlogaritur për të mbuluar periudhën shtator-dhjetor 2009.

VENDIM
Nr.965, datë 30.9.2009

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË OBJEKTE, PRONË PRIVATE, SI RRJEDHOJË E TËRMETIT, RËNË NË QARKUN E DIBRËS, DHE TË LISTAVE EMËRORE, ME VLERAT PËRFITUESE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e tërmetit, rënë në qarkun e Dibrës, në shumën 129 359 122 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, të përcaktuar në fund të përmbledhëses, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Miratimin e listave, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me emrat dhe shumat përkatëse të kompensimit, si rezultat i procesit të vlerësimit.

3. Fondi, prej 129 359 122 (njëqind e njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

- 100 000 000 (njëqind milionë) lekë nga buxheti i vitit 2009, miratuar për Ministrinë e Brendshme;

- 29 359 122 (njëzet e nëntë milionë e treqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e njëzet e dy) lekë, nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

4. Kryerja e pagesave personave përfitues të bëhet nga këshilli i qarkut Dibër.

5. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe këshilli i qarkut Dibër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 5.8.2010

Doli nga shtypi më 7.8.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 36 lekë